



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË  
KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA SOCIALISTE, PJESTARE E  
KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE", PËR ZGJEDHJET PËR  
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për miratimin e listave shumëmeore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës të paraqitura nga "Partia e Socialiste", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga "Partia Socialiste", si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia Socialiste, me vendimin e KQZ-së nr. 148, datë 11.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr. 251, datë 07.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe "Partia Socialiste".



**Nr. 619 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumëmeore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Socialiste", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkive: Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës; pasi bashkitë Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës, administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës, të propozuar nga Partia Socialiste;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datë 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive: Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës të Partisë Socialiste dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se:

## **Lista shumemërore e Bashkisë Vlorë**

### **1. Kandidati me numër rendor 23, Z. Kreshnik Skënder Tepelena**

- Në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit (A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj), i është përgjigjur me (Po) duke deklaruar se:
  - me vendimin nr. 266 datë 31.05.2012, është dënuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, për veprën penale "Kundërshtim i Punonjësve të policisë së rendit publik" parashikuar nga neni 236/2 K.P, ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 100.000 lekë gjobë;
  - me vendimin nr. 684 datë 21.12.2007, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale "Moskallëzim i Krimit" parashikuar nga neni 300 K.P, ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit 100.000 lekë gjobë;



- Në pikën 4 të formularit të vetëdeklarimit (A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale), i është përgjigjur me (Po) duke deklaruar se:
  - është ndaluar nga Policia e Qarkut Vlorë në datë 15.12.2010 deri më 18.12.2010, për arsye "Arrest për veprën penale të parashikuar nga neni 236/1 K.P".
  - është ndaluar nga Policia e Qarkut Durrës në vitin 2007, për arsye "Arrest për veprën penale të parashikuar nga neni 300 K.P".

### **Lista shumemërore e Bashkisë Durrës**

- Kandidati me numër **rendor 39, Z. Alban Mehdi Ramohitaj**, Në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit (A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj), i është përgjigjur me (Po) duke deklaruar se:
  - me vendimin nr. 91 datë 20.02.2004, është dënuar nga Gjykata e Apelit Durrës, për veprën penale "Vjedhje e energjisë elektrike" parashikuar nga neni 137/2 K.P dhe 406 K.Pr.P, ndaj të cilit është vendosur masa e dënimit Në rast përsëritje 2 muaj me kusht për një periudhë 18 muaj;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillin bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, nga ku rezulton se:

### **Lista shumemërore e Bashkisë Elbasan**

Kandidati **znj. Nada Gezim Teta**, në bazë të vendimit nr. 13-2018-6164 datë 30.10.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Punësim i paligjshëm", e në bazë të nenit 170/a/1, të Kodit Penal dhe e dënon me 1 muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 K.P pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim duke e zëvendësuar atë me detyrimin e të pandehurit të mësipërm që të kryejë 40 orë punë në interes publik.

### **Lista shumemërore e Bashkisë Lezhë**

Kandidati **z. Xhovan Lek Marku**, Bashkia Lezhë, në bazë të vendimit nr. 143-941 datë 17.03.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt", e në bazë të nenit 291, 51 të Kodit Penal dhe nenit 406/1 Kodit Procedurës Penale e dënon me 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 Kodi Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe vihet në provë për 18 muaj. Në bazë të nenit 69 Kodi Penal. Në bazë të nenit 69 rehabilitohet.



## Lista shumemërore e Bashkisë Durrës

Kandidati me numër **rendor 19, z. Indrit Osman Çerloi**, Bashkia Durrës, në bazë të vendimit nr. 19 datë 13.02.1998 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Largim pa leje nga reparti", parashikuar në nenin 35/1 K.P Ushtarak, neni 48/ç, e 9 i K.P Ushtarak. E dënon përfundimisht me 3000 lekë gjobë e cila do të shlyhet deri më datë 12.03.1998.

Në bazë të nenit 69 Kodi Penal është rehabilituar.

Në bazë të vendimit nr. 427 datë 16.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është deklaruar fajtor për veprën penale të "Plagosjes së lehtë me dashje", parashikuar në nenin 89 Kodi Penal dhe në bazë të këtij neni e dënon me gjobë në shumën 60.000 lekë. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.P e dënon përfundimisht me gjobë në shumën 40.000 lekë.

Në bazë të nenit 69 Kodi Penal është rehabilituar.

Në bazë të vendimit nr. 827 datë 22.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pushim i çështjes penale "Mashttrim në sigurime", parashikuar nga neni 145 të Kodit Penal pasi ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 271 datë 28.02.2013 ka vendosur mospranimin e ankimit me vendimin nr. 827 datë 22.12.2011 të Gjykatës së Rrethit.

Kandidati me numër **rendor 15, z. Jurgen Luan Dashi**, Bashkia Durrës, në bazë të vendimit nr. 155 datë 25.02.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Refuzim për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nënpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", parashikuar nga neni 257/A/1 K.P duke e dënuar me 30 ditë burgim.

Në aplikim të nenit 406 K.Pr.P e dënon përfundimisht me 20 ditë burgim. Në aplikim të nenit 63 K.P urdhërohet ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimi me 60 orë pune në interes publik.

Kandidati me numër **rendor 59, z. Esat Hamit Lica**, Bashkia Durrës, në bazë të vendimit nr. 958 datë 10.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Durrës, është deklaruar fajtor për veprën penale të "Ndërtimi i paligjshëm" është deklaruar fajtor për veprën penale ndërtim i paligjshëm në tokën truallin e tij, dhe në bazë të nenit 199 /A paragrafi i parë ,48, gërma "ç" e 49 të K.Penal e dënon me 4 (katër) muaj 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. Në aplikim të nenit 406 K.PR.P pezullohet ekzekutimi i vendimit me burgim dhe zëvendësohet me 70 (shtatëdhjetë) orë pune interes publik. Zëvendësohet me 70 (shtatëdhjetë) orë pune interes publik. Rehabilitohet në bazë të Nenit 69 të Kodit Penal.

Kandidati me numër **rendor 27, z. Mahmut Arif Mani**, Bashkia Durrës, bazë të vendimit nr. 663 datë 07.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është deklaruar fajtor për veprën penale "Falsifikim i dokumentave shkollorë", neni 187/1 të K.Penal dhe dënohet me 100.000 lekë gjobë.

Bazuar në nenin 406/1 të K.Pr.P i zbritet 1/3 e dënimit dhe dënohet me 66.700 lekë gjobë. Rehabilitohet në bazë të Nenit 69 të Kodit Penal.

Kandidati me numër **rendor 39, z. Alban Mehdi Ramohitaj**, Bashkia Durrës, në bazë të vendimit nr. 91 datë 20.02.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është deklaruar fajtor për veprën penale të "Vjedhjes së energjisë elektrike" dhe në bazë të nenit 137/2 të K.P dhe nenit 406 të K.Pr.P e dënon me 2 muaj burg.



**Nr. 619 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Socialiste", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 59 të K.P pezullohet ekzekutimi i dënimit të dhënë për një afat kohe prej 18 muaj.

Rehabilituar në bazë të Nenit 69 të K.Penal.

### **Lista shumemërore e Bashkisë Vlorë**

Kandidati me numër **rendor 23, z. Kreshnik Skënder Tepelena**, Bashkia Vlorë, në bazë të vendimit nr.684 datë 21.12.2007 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e deklaroi fajtor për veprën penale të moskallëzimit të krimin dhe në bazë të nenit 300 të K.P e denon me 100.000 lekë gjobë.

Në bazë të nenit 69 të K.P është rehabilituar.

Me vendimin nr.280 datë 14.06.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik", parashikuar nga neni 236/2 të K.P.

Me vendimin nr.266 datë 31.05.2012 Gjykata e Apelit Vlorë vendosi ndryshimin e vendimit nr.280 datë 14.05.2012, deklarimin fajtor e në bazë të nenit 236/2 të K.P e dënonte atë me 100.000 (njqind mijë) lekë gjobë.

Në bazë të Nenit 69 të K.Penal është rehabilituar.

### **Lista shumemërore e Bashkisë Kamëz**

Kandidati me numër **rendor 02, z. Halil Ramiz Kaloshi**, Bashkia Kamëz, në bazë të Vendimit nr.739 datë 10.05.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale "Kundërshtim e punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, fyerje për shkak të detyrës dhe në bazë të Nenit 235/1, 239/2, 55 të K.P është denuar me 50.000 lekë gjobë.

Rehabilituar në bazë të Nenit 69 të K.Penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015.

KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 22.05.2015, verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës, dhe dokumentacionin bashkëngjitur, të depozituar nga "Partia Socialiste" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



**Nr. 619 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Socialiste", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

## V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkive: Lushnjë, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Korçë, Tiranë, Fier, Vlorë, Kamëz, Durrës, të Partisë "Socialiste", pjesëtare të Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 619 i Vendimit**

**Data 22.05.2019**

**Ora 17:00 e Vendimit**

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Socialiste", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019